



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALIQ
KRYETARI**

Nr. 3285 Prot

Maliq, më 09.07.2024

Lënda: Kërkesë për thirrje jashtë radhe të mbledhjes së Këshillit Bashkia Maliq

Drejtuar : - **KRYETARIT TË KËSHILLIT TË BASHKISË**

Z. ORNILDI DEMOLLARI

- **KËSHILLIT TË BASHKISË**

MALIQ

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 53 “*Funksionimi i këshillit bashkiak*” pika 3 gërma a),

Thirrjen jashtë radhe online të mbledhjes të Këshillit të Bashkisë Maliq, ditën e **Enjte** datë **11.07.2024** ora **10^{oo}** me këtë

Rend Dite :

1-Ndryshim emërtimi dhe rishpërndarje fondi në buxhetin e Bashkisë Maliq për vitin 2024

Bashkëngjitur keni projekt-vendimin dhe relacionin përkatës.

Falemindrit

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim TOPÇIU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KRYETARI

Nr. 3285 Prot.

Maliq, më 09.7.2024

Lënda : Dërgohet material për shqyrtim dhe miratim

KËSHILLIT TË BASHKISË

MALIQ


Të nderuar këshilltarë !

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për miratim Projekt-Vendimin nr. 1, datë 09.7.2024 për

"Ndryshim emërtimi dhe rishpërndarje fondi në buxhetin e Bashkisë Maliq për vitin 2024 "

KRYETARI

GËZIN TOPCIU



Konceptoi : Almira Muka, Drejtor i Financës dhe Buxhetit

Data: 09.7.2024

Nr. faqeve të projekt vendimit 09 107

Nr. i fletëve të dokumentave që shoqërojnë projekt-vendimin 1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

KRYETARI

Maliq,më 09.07.2024

PROJEKT –VENDIM

Për

" Ndryshim emërtimi dhe rishpërndarje fondi në buxhetin e Bashkisë Maliq për vitin 2024 "

Në mbështetje të ligjit 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 54 "Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak, gërma dh), ligjit 9936 datë 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" neni 32 "Përgatitja dhe miratimi i buxheteve vendore ", ligjit nr. 68/2018 "Per financat e vetëqeverisjes vendore" neni 21/3 -Burimet e financimit te qarkut, neni 45 "Rishpërndarjen e fondeve buxhetore", ligjit nr. 97/2023 "Per buxhetin e vitit 2024", mbështetur në vendimin nr. 138 datë 26.12.2023 të Këshillit Bashkiak "Për miratimin e buxhetit për vitin 2024 " Udhezimin plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 1 datë 24.01.2024 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024", i kërkoj Këshillit të Bashkisë:

1-Të miratojë ndryshim emërtimi dhe rishikim të buxhetit për vitin 2024 si më poshtë :

Pakësim

| Gr. | Kap. | Kod. | Prog | Llog.Ek. | Kodi | Objekti | <i>në lekë</i> |
|-----|------|-------|------|----------|------|---|-------------------------|
| 00 | 05 | 01110 | 230 | 1680324 | | Bashkëfinancim projekte Këshilli i Qarkut | <u>2,077,000</u> |

Shtesa

| | | | | | | | |
|--|----|-------|-----|---------|--|--|-------------------------|
| 00 | 05 | 01110 | 604 | 9999999 | | Transferime korrente të brendshme për bashkëfinancim projektsh | |
| (Këshillit të Qarkut Korçë) në shumën | | | | | | | <u>2,077,000</u> |

2.Për zbatimin e vendimit ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.

3.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë mbas miratimit.

Konceptoi : A.Muka

KRYETARI I BASHKISË





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
Drejtoria e Financës dhe Buxheti

RELACION

“Për ndryshim emërtimi dhe rishpërndarje të fondeve buxhetore“

Të nderuar këshilltarë !

Në mbështetje të ligjit 139/2015 date 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 54 "Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak", germa dh , ligjit 9936 datë 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" neni 32 "Përgatitja dhe miratimi i buxheteve vendore", ligjit Nr 68/2018 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 21/3 -Burimet e financimit të qarkut, neni 45 "Rishpërndarjen e fondeve buxhetore", ligjit nr. 97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024", mbështetur në vendimin nr. 138 datë 26.12.2023 të Këshillit Bashkiak "Për miratimin e buxhetit për vitin 2024 "Udhezimin plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.1 datë 24.01.2024 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024" ,vendimit të Këshillit të Qarkut Korçë nr. 14 date 15.03.2024, kërkesës për derdhjen e kontributeve të Bashkive për Këshillin e Qarkut Korçë me qëllim vijimin e projekteve të investimeve .

Në buxhetin e vitit 2024 fondi për Këshillin e Qarkut është me objekt : “Bashkëfinancim projekte për këshillin e qarkut” në grupin Hartim Projekte , në llogarinë ekonomike 230, sipas vendimit të Këshillit të Qarkut dhe kërkesës së bërë për zbatimin e projekteve është e nevojshme që ky fond të derdhet si kontribut, pra transferime korrente të brendshme në llogarinë ekonomike 604 në vlerën 2,077,000 lekë për efekt bashkëfinancimi për këtë qëllim.

Ndodhur në këto kushte kërkojmë nga ana e juaj që për vlerat e sipërcituara të bëhen ndryshimet përkatëse për ndryshim emërimi dhe rishikim të Buxhetit për vitin 2024,për të njëjtin qëllim në hartimin e projekt - preventivave të objekteve:

1. Projekt “Rehabilitim i Lagjes Muze“Maliq ne vleren totale 923,000 bashkia financon **277,000 lekë**, Këshilli i Qarkut financon **646,000 lekë**.
2. Projekt “Ndërtim i muzeut të palafiteve të tharjes së kënetës së Maliqit“ ne vleren totale 6,000,000 lekë, Bashkia financon **1,800,000 lekë**, Këshilli i Qarkut financon **4,200,000 lekë**.

Totali gjithsej i financimit të Bashkisë **2,077,000 lekë**.

Totali që do të mbulojë Këshilli i Qarkut **4,846,000 leke**

Për këtë i drejtohem Këshillit Bashkiak me Projekt Vendim për ndryshim emërtimi dhe rishikim të Buxhetit të Bashkisë Maliq për vitin 2024 në një kohë sa më të shpejtë për të vazhduar me procedurat e tjera .

Faleminderit

Drejtor i financës dhe buxhetit

Almira MUKA

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim TOPÇIU

